

# Lehtësimi i regjimit të vizave për qytetarët e ish Republikës jugosllave të Maqedonisë





Udhëtimi më i lehtë në UE po bëhet realitet për qytetarët e ish Republikës jugosllave të Maqedonisë – ky është qëllimi i marrëveshjes lehtësuese midis UE-së dhe ish Republikës jugosllave të Maqedonisë. Qëllimi i regjimit të ri të vizave është lehtësimi në dhënie **vizave afatshkurte** për personat që janë shtetas të këtij vendi. Ky lehtësim duhet të ndihmojë që perspektiva evropiane e ish Republikës jugosllave të Maqedonisë të jetë më konkrete për qytetarët e vet. Lehtësimi i vizave është hapi i parë konkret drejt regjimit të liruar nga vizat për udhëtim.

Marrëveshja për lehtësimin e vizave ka përparësi për të gjithë shtetasit e ish Republikës jugosllave të Maqedonisë që udhëtojnë në UE, dhe atë me pagesën e ulët (35 euro në vend të shumës 60 euro, që po aplikohet në përgjithësi) dhe shqyrtimin më të shpejtë të aplikacioneve për viza (maksimum 10 ditë, si parim kryesor). Ky lehtësim

ka përparësitë e veta për grupet e mëdha, në aspektin e thjeshtësimin të kërkesave për dokumentacioni e udhëtimit dhe qartësimin e rregullave në rastet e dhënies së vizës me më tepër hyrje. Për kategori të veçanta, siç janë vizat e studentëve ose pensionerëve, vizat do të jenë pa pagesë.

Kjobroshurë përmban **informata themelore** për aplikantët që duan të mësojnë rregullat dhe parimet e dhënies së vizave afatshkurte. Shtetet anëtare të UE-së, do të marrin hapa për të siguruar se marrëveshjet aktuale janë në pajtim me frymën e marrëveshjes së lehtësimin të vizave dhe duhet të mundësojnë **qasjen në informata plotësuese dhe të hollësishme në ueb faqet e shërbimeve të tyre konsulare. Informata plotësuese mund të gjeni edhe në faqet e internetit të Delegacionit të KE-së në Shkup (<http://www.delmkd.ec.europa.eu/en/index.htm>) dhe në atë të qeverisë së ish Republikës jugosllave të Maqedonisë ([www.mfa.gov.mk](http://www.mfa.gov.mk)).**

## 1. Viza afatshkurte

- A planifikoni të qëndroni në një ose më tepër shtete anëtare të UE-së për **më pak se 90 ditë** në periudhë prej 180 ditësh?
- Doni të kaloni përmes territorit të një ose më tepër shteteve anëtare të UE-së?

Në këto raste ju duhet **vizë afatshkurte**, që nënkupton autorizimin e dhënë nga një shtet anëtar i UE-së për qëndrimin ose kalimin tuaj në një ose më tepër shtete anëtare.

### Informata të rëndësishme


Rregullat e reja të lehtësimin të vizave vlejné për të gjitha shtetet anëtare të UE-**përveç** për Britaninë e Madhe, Irlandën dhe Danimarkën. Këto shtete anëtare inkurajohen të nënshkruajnë marrëveshje të veçanta me përmbajtje të ngjashme si marrëveshja e UE-së. Marrëveshje të veçanta nevojiten edhe me Norvegjinë dhe Islandën.

### Ku të aplikoni?

- Për vizë mund të aplikoni në shërbimet konsulare të shteteve anëtare të Unionit European, në të cilat dëshironi të realizoni qëndrimin tuaj të shkurtër.
- Për qëndrim të shkurtër në më tepër shtete anëtare të UE-së, duhet të drejtoheni në konsulatën **shtetit që e keni si destinacion kryesor të udhëtimit**.
- Nëse është vështirë të përcaktoni destinacionin kryesor, duhet të shkoni në konsulatën **shtetit në të cilin do të realizoni hyrjen e parë në zonën e Shengenit**.

### Cilat janë kërkesat minimale për të aplikuar për vizë? Duhet të:

- Mbushni dhe nënshkruani formularin e aplikimit për vizë.
- Tregoni pasaportë e cila do të jetë e vlefshme së paku tre muaj pas skadimit të afatit të vizës së kërkuar.
- Saktësoni mjetet e transportit (mënyrën e udhëtimit).
- Vërtetoni se keni mjete të mjaftueshme të ekzistencës për qëndrimin tuaj dhe udhëtimin tuaj.
- Vërtetoni se keni sigurim shëndetësor që është i vlefshëm për këtë udhëtim.
- Përshkruani qëllimin dhe rrethanat e vizitës suaj.





Rregullat e reja të lehtësimit të vizave vlejnë edhe për pikën në vijim:

Shembujt në listën e mëposhtme janë studime rastesh për orientimin tuaj. Ju informojmë se kjo listë shërben për orientim dhe nuk ka për qëllim t'ju japë të gjitha informatat. Nëse përkisni në njerën nga kategoritë në vijim, për të vërtetuar qëllimin e udhëtimit tuaj do t'ju nevojiten vetëm dokumentet që janë shënuar më poshtë; nuk nevojitet

asnjë vërtetim, ftesë apo miratim tjetër. Megjithatë, të gjitha kërkesat tjera të nevojshme për marrjen e vizës, siç janë prezantimi i dokumenteve që vërtetojnë mjetet e ekzistencës, mbeten të pandryshuara dhe duhet të kontrollohen nga konzullati ku planifikoni të dorëzoni aplikacionin e vizës.

**Qëllimi i vizitës suaj të shkurtër në shtet të UE-së**

**Nëse jeni ...**

**atëherë duhet të justifikoni qëllimin e udhëtimit tuaj duke prezantuar:**

**Profesional**

... biznesmen...

një kërkesë me shkrim nga personi juridik ose autoriteti publik nikoqir.

... dhe merrni pjesë në ekspozita, konferenca, simpoziume, seminare ndërkombëtare...

një kërkesë me shkrim nga organizata nikoqire.

... nxënës, student ose profesor shoqërues...

një kërkesë me shkrim ose certifikatë të regjistrimit nga universiteti nikoqir, kolexhi ose shkolla.

... dhe merrni pjesë në evenimente shkencore, kulturore, artistike ose sportive...

një kërkesë me shkrim nga organizata nikoqire.

**Privat**

... farefisi i afërt – bashkëshort/e, fëmijë, ose prind i shtetasit të këtij vendi me qëndrim legal në një shtet anëtar të UE-së ...

një kërkesë me shkrim nga farefisi që do të vizitoni.

... person që planifikon të vizitojë një shtet anëtar të UE-së për arsye shëndetësore ose shoqërues i domosdoshëm...

një dokument zyrtar nga institucioni mjekësor dhe vërtetim për mjete të mjaftueshme financiare për të paguar trajtimin mjekësor.

... udhëtoni si turist...

një certifikatë ose garancë nga agjencia turistike ose agjencia e udhëtimit.

... merrni pjesë në ceremoni funerali..

dokument zyrtar që konfirmon vdekjen, si dhe vërtetim për lidhjen familjare ose relacionin tjetër.


## Informata të rëndësishme

Ju informojmë se ligji i UE-së ose ai nacional, vazhdon të vlejë për të gjitha çështjet që nuk janë të përfshira në marrëveshjet e lehtësimit të vizave, siç janë: refuzimi në dhënien e vizave, njohja e dokumenteve të udhëtimit, kërkesa e përgjithshme për prezencën personale gjatë dorëzimit të aplikacionit të vizës, mundësia që në raste të dyshimita individuale, aplikantët të ftohen në intervista personale, refuzimi i hyrjes dhe masat e dëbimit por gjithashtu edhe trajtimi fleksibil i udhëtarëve të mirëbesueshëm.

## 2. Viza afatshkurte me shumë hyrje (multi)

**Viza afatshkurte me shumë hyrje për në UE, valide për një vjet, do të jepet nëse**

- Gjatë vitit paraprak keni marrë së paku një vizë
- E keni përdorur atë në pajtim me ligjet e hyrjes dhe qëndrimit në shtetet anëtare të UE-së
- Rregullisht udhëtoni në shtetet anëtare të UE-së dhe jeni:
  - **biznesmen**
  - **anëtar i grupeve që marrin pjesë në ekspozita, konferenca, simpoziume dhe seminare ndërkombëtare ose evenimente të ngjashme**
  - **person që ka nevojë të udhëtojë rregullisht për arsye mjekësore ose të shoqërore personin për arsyet e lartpërmendura**
  - **person që rregullisht merr pjesë në aktivitete shkencore, kulturore, sportive ose artistike**
  - **student që udhëton rregullisht për qëllime studimi ose trajnime edukative**




**Viza afatshkurte me më tepër hyrje në UE, valide për së paku 2 vjet dhe maksimum 5 vjet, do t'ju jepet nëse**

- i përkisni një rës nga kategoritë e lartpërmendura
- gjatë vitit paraprak keni përdorur vizën njëvjeçare me më tepër hyrje, në pajtim me ligjet e hyrjes dhe qëndrimit në shtetin anëtar të UE-së dhe
- arsyet për kërkesën e vizës multi vlejshme akoma



### 3. Sa duhet të paguani për vizën afatshkurte?

Pagesa për procesimin e aplikacionit tuaj të vizës është **35 euro**. Kjo shumë vlen njëlloj si për vizat me një hyrje ashtu edhe për ato multi.



#### Vizat pa pagesë do të vlejné për këto kategori:

- **Farefisi i afërt.**
- Personat që kanë prezantuar dokumentacion që vërteton nevojën e udhëtimit të tyre në **baza humanitare**, përfshirë **këtu trajtimin mjekësor urgjent** dhe personin që shoqëron këtë person; për të marrë pjesë në varrim të farefisit të afërt ose për të vizituar anëtarin e familjes së afërt, që është seriozisht i sëmurë.
- **Penzionerët.**
- **Fëmijët ndër 6 vjet.**
- **Personat e hendikepuar** dhe personi që i shoqëron ata, nëse është e nevojshme.
- **Nxënësit, studentët dhe mësuesit shoqëruar** të cilët shkojnë në udhëtime për qëllime të shkollimit ose për trajnime edukative, përfshirë këtu edhe programet e këmbimit si dhe aktivitetet e tjera që kanë të bëjnë me shkollim.
- Personat që marrin pjesë në **aktivitete shkencore, kulturore, sportive dhe artistike**, përfshirë këtu universitetet dhe programet këmbyses.



### 4. Sa do të zgjasin procedurat e aplikacionit tuaj të vizës?

Misioni diplomatik dhe postet konsulare të shteteve anëtare të UE-së, pas kërkesës për vizë, do të marrin vendim **në periudhë brenda 10 ditësh kalendarike** nga dita e pranimit të aplikacionit dhe dokumenteve të nevojshme.

Kjo periudhë kohore mund të redukohet në 3 ditë pune ose më pak në **rastet urgjente**. Në raste të veçanta, mund të zgjatet deri në 30 ditë, sidomos në rastet kur kërkohet shqyrtim i mëtejshëm i aplikacionit.



